

Është mbajtur seanca konstituive e Komisionit Kombëtar për UNESCO të RMV me përbërjen e re

Në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut sot kështë mbajtur seancë konstituive e Komisionit Nacional për UNESCO të RMV me përbërjen e re.

Seancën e drejtoi ministrja e Kulturës dhe kryetarja e Komisionit Kombëtar, Bisera Kostadinovska-Stojčevska.

Në seancën e parë të përbërjes së re të Komisionit Kombëtar u shqyrtua dhe u miratua Rregullorja e Punës, si dhe u shqyrtuan dhe renditen projektet e dorëzuara në Thirrjen për paraqitjen e propozim-projekteve në suaza të Programit për pjesëmarrje të UNESCO-s për vitet 2022 - 2023.

Në përputhje me kriteret e UNESCO-s, çdo shtet anëtar, nëpërmjet komisioneve të tij kombëtare, mund të paraqesë në UNESCO më së shumti 7 propozim-projekte nga 5 fushat kryesore programore të UNESCO-s dhe 1 projekt rajonal më së voni deri më 28 shkurt të vitit 2022.

Bashkangjitur është Aktvendimi për emërimin e Presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe anëtarëve të Komisionit Kombëtar për UNESCO të Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 8 shkurt të vitit 2022, botuar në “Zyrtare Gazeta e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 36/22.